



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE
Në zbatim të ligjit nr. 119/2024, “Për të drejtën e informimit”,

Nr.	Data e rregjistrimit të kërkesës	Objekti	Data e kthimit të përgjigjes	Përgjigje	Mënyra e përfundimit të kërkesës	Tarifa
1	6 janar 2026	<p>1. A ka pasur raste ku personat e komunitetit rom i janë drejtuar Avokatit të Popullit duke kërkuar mbrojtje për:</p> <ul style="list-style-type: none">○ gjuhë urrejtjeje online,○ bullizëm në internet,○ ngacmim apo stigmatizim në portale lajmesh, rrjete sociale apo media të tjera online? <p>Nëse po, sa raste janë trajtuar në 3–5 vitet e fundit?</p> <p>2. Cilat kanë qenë format më të shpeshta të shkeljeve të raportuara (p.sh. stereotipe etnike, publikim fyese, koment diskriminues, shpifje, përmbajtje denigruese etj.)?</p> <p>2. Veprimet e Institucionit</p> <p>Ju lutem të sqaroni:</p> <p>3. Si reagon Institucioni i Avokatit të Popullit kur merr ankesa për gjuhë urrejtjeje apo diskriminim online ndaj komunitetit rom?</p>	19.Janar 2026	<p>Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion, datë 06.01.2026, lidhur me mbrojtjen e të drejtave të komunitetit rom në kontekstin e gjuhës së urrejtjes, bullizmit dhe ngacmimit në mediat online dhe rrjetet sociale, ju përcjellim bashkëlidhur përgjigjen zyrtare të Institucionit të Avokatit të Popullit.</p> <p>Gjithashtu, për informacion të mëtejshëm, ju ftojme të vizitoni faqen zyrtare të institucionit: www.avokatipopullit.gov.al, si dhe në veçanti rubrikën e raporteve vjetore në linkun: https://www.avokatipopullit.gov.al/sq/list/publications/rraporte-vjetore-2/?page=1</p> <p>Në këto publikime mund të gjeni të dhëna dhe analiza mbi çështje të të drejtave të njeriut, trajtimin e ankesave dhe hetimeve administrative, si dhe rekomandimet e adresuara ndaj institucioneve përgjegjëse.</p>	E plote	Falas

		<ul style="list-style-type: none"> ○ A kryhet hetim administrativ? ○ A kërkohet bashkëpunim me Prokurorinë, Policinë e Shtetit, AMA-n apo institucione të tjera? ○ A nxirren rekomandime? <p>4. A ka mekanizma të veçantë të parashikuar nga institucioni për kategori vulnerabël, si komuniteti rom, që janë më të ekspozuar ndaj sulmeve online?</p> <p>3. Plane dhe angazhime institucionale</p> <p>5. A ka Avokati i Popullit programe, nisma, politika ose bashkëpunime me shoqërinë civile për të adresuar:</p> <ul style="list-style-type: none"> ○ diskriminimin online, ○ mbrojtjen e komunitetit rom, ○ monitorimin e rrjeteve sociale, ○ edukimin e publikut mbi të drejtat e njeriut? 				
2	9 janar 2026	<ol style="list-style-type: none"> 1. Numrin e ankesave të depozituara nga organizatat jofitimprurese (OJF) ose grupe informale lidhur me kufizimin e ndalimin e tubimeve paqësore si dhe statusin e trsjtimit te tyre. 2. Numrin e ankesave të paraqitura nga OJF-të ose grupe informale lidhur me përdorimin e dhunës nga organet e zbatimit të ligjit gjatë organizimit ose zhvillimit të tubimeve paqësore. 3. Raste të identifikuar nga institucioni juaj që lidhen me kufizimin e veprimtarisë së medias gjatë tubimeve paqësore. 4. Numrin e ankesave të paraqitura nga OJF-të, përfaqësuesit e tyre ose grupe informale lidhur me survejimin, monitorimin ose ndërhyrjen në komunikimin on-line (media sociale, faqe interneti, email, etj) nga autoritetet shtetërore, si dhe numrin e rasteve të shqyrtuara. 5. Numrin e rasteve të raportuara për bllokim, ndërhyrje ose hakerim të kanaleve të komunikimit të OJF-ve (email, faqe interneti, rrjete sociale) 6. Numrin e rasteve kur OJF, përfaqësuesit e tyre ose grupe informale janë ndjekur penalisht ose proceduar administrativisht për shkak të aktivitetit online. 7. Numrin e raportimeve nga OJF-të, përfaqësuesit e tyre ose 	22 janar 2026	Në përgjigje të kërkesës gjatë vitit 2025 nuk janë regjistruar ankesa të paraqitura nga OJF, grupe informale, aktivistë, media, apo raste me iniciativë.	E plote	Falas

		<p>grupe lidhur me kërcënime, intimidim, ngacmime me dhune, të ushtruara nga zyrtarë oublekë ose palë të treta për shkak të veprimtarisë ose aktivizimit të tyre.</p> <p>8. Numrin e rasteve të raportuara për ndërhyrje të autoriteteve shtetërore në funksionimin e brendshëm të OJF-ve, përfshirë ndërprerje aktivitetesh, kontrolle administrative, bastisje ose sekuestrim pasurie.</p> <p>9. Numrin e rasteve të vetëcensures, përfshirë përfaqësues të OJF-ve ose aktivistë, të identifikuar përmes ankesave, gjetjeve ose vlerësimeve të institucionit tuaj.</p> <p>10. Numrin e rasteve të raportuara që lidhen me përdorimin e teknologjive të reja dhe emergjente për shkelje të të drejtave dhe lirive themelore</p>				
3	19 janar 2026	<ul style="list-style-type: none"> • Si garantoen të drejtat e qytetarëve për privatësinë dhe mbrojtjen e të dhënave personale, veçanërisht të dhënat biometrike (retina, targa, lëvizjet e qytetarëve), në kuadër të projektit Smart City? • A mund të nisë Avokati i Popullit shqyrtimin e projektit “Smart City” për të garantuar mbrojtjen e të dhënave personale të qytetarëve, duke përfshirë të dhënat biometrike dhe monitorimin e lëvizjeve, veçanërisht kur prek një numër të madh individësh? • Cilat hapa mund të ndërmarrë Avokati i Popullit për të bërë rekomandime konkrete tek organet e administratës publike në lidhje me shkeljet e mundshme të të drejtave të qytetarëve ose përdorimin e panevojshëm të fondeve publike për projektin “Smart City”? 	29 janar 2026	<p>1. Roli dhe kompetencat e Avokatit të Popullit</p> <p>Avokati i Popullit, në përputhje me nenin 60 të Kushtetutës dhe ligjin nr. 8454/1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ka si funksion mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të individëve nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme të organeve të administratës publike.</p> <p>Ushtrimi i kompetencave të Avokatit të Popullit realizohet mbi bazën e shqyrtimit të ankesave konkrete, të individualizuara, ose kur nga të dhëna të besueshme rezultojnë indicie për shkelje të të drejtave të njeriut.</p> <p>2. Lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale dhe privatësinë</p> <p>Mbrojtja e të dhënave personale dhe respektimi i jetës private janë të garantuara nga Kushtetuta dhe nga legjislacioni në fuqi. Autoritetet publike janë të detyruara të përpunojnë të dhënat personale vetëm në përputhje me bazën ligjore përkatëse dhe</p>	E plote	Falas

				<p>parimet e domosdoshmërisë, proporcionalitetit dhe sigurisë.</p> <p>Avokati i Popullit ndjek me vëmendje çështjet që lidhen me respektimin e këtyre të drejtave dhe ushtron kompetencat e tij brenda kufijve të përcaktuar nga ligji.</p> <p>3. Lidhur me projektin “Smart City”.</p> <p>Sa i përket projektit “Smart City”, Avokati i Popullit vlerëson çdo çështje që lidhet me ndikimin e tij të mundshëm mbi të drejtat e qytetarëve nëse paraqiten ankesa konkrete apo fakte të verifikueshme që tregojnë shkelje të të drejtave dhe lirive themelore.</p> <p>Kërkesa juaj parashtron shqetësime me karakter të përgjithshëm, të cilat, në këtë fazë, nuk shoqërohen me elementë faktikë konkretë apo akte administrative të individualizuara, që të mundësonin nisjen e një procedimi të posaçëm nga Avokati i Popullit.</p> <p>4. Lidhur me rekomandimet ndaj organeve të administratës publike</p> <p>Avokati i Popullit jep rekomandime ndaj organeve të administratës publike vetëm në rastet kur, pas shqyrtimit të një ankese konkrete, konstatohet shkelje e të drejtave të njeriut. Institucioni nuk ushtron kompetenca mbikëqyrëse të përgjithshme mbi politikat publike dhe nuk ndërhyr në diskrecionin administrativ të organeve shtetërore, për sa kohë ky diskrecion ushtrohet në përputhje me ligjin.</p> <p>5. Përfundim</p>	
--	--	--	--	---	--

				Në kushtet e mësipërme, Avokati i Popullit mbetet i hapur për shqyrtimin e çdo ankese të ardhshme të paraqitur në përputhje me kriteret ligjore, e cila përmban elementë konkretë që lidhen me shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të qytetarëve.		
4	19 janar 2026	Në mbështetje të Ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, kërkoj vënien në dispozicion të Raportit për vitin 2024 mbi aplikimin dhe respektimin e të drejtave të njeriut, të përgatitur, miratuar ose administruar nga institucioni juaj. Nëse raporti është i shoqëruar me dokumente mbështetëse, analiza, rekomandime, statistika ose akte të tjera shoqëruese, kërkoj gjithashtu vënien në dispozicion të tyre.	20 janar 2026	https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/reports/AVOKATI%20I%20POPULLIT%20-%20RAPORTI%20VJETOR%202024%20.pdf	E plote	Falas
5	20 janar 2026	Trajtimi i ankesave të qytetarëve ndaj punonjësve të administratës publike. Konkretisht dua të marr informacion mbi procedurat që mund të ndiqen nga Avokati i Popullit në këto raste dhe cila mund të jetë zgjidhja.	21 janar 2026	https://www.avokatipopullit.gov.al/sq/article-ildp-layout/transparency	E plote	Falas
6	5 shkurt 2026	<p>Sa kërcënime ndaj jetës apo lëndime trupore ka pasur ndaj gazetarëve gjatë periudhës 1 janar-31 dhjetor 2025?</p> <ul style="list-style-type: none"> • Sa kërcënime të tjera, ngacmime, sulme fizike apo forma të tjera dhune ndaj gazetarëve ka pasur gjatë periudhës 1 janar-31 dhjetor 2025? • A ka pasur raste të kërcënimeve dhe sulmeve ndaj mediave apo organizatave mediatike për periudhën 1 janar-31 dhjetor 2025? • Sa raste të sulmeve dhe kërcënimeve online ndaj gazetarëve dhe profesionistëve të tjerë të medias ka pasur gjatë periudhës 1 janar-31 dhjetor 2025? • A ka pasur gjatë periudhës 1 janar-31 dhjetor 2025 cenim të lirisë së shprehjes të gazetarëve në media? • Gjatë periudhës 1 janar – 31 dhjetor 2025 sa ankesa me subjekt gazetarë apo profesionist të medias kanë ardhur për shqyrtim? <ul style="list-style-type: none"> • Në rast se ka pasur raportime lidhur me pyetjet e mësipërme do të donim të mësonim se si ju si institucion keni vepruar dhe si ka qenë bashkëpunimi me institucionet e lidhura përgjegjëse? • Cilat kanë qenë rekomandimet që ju si institucion keni sugjeruar ndaj institucioneve përgjegjëse për marrjen e masave të nevojshme për respektimin e të drejtave të gazetarëve dhe 	17 shkurt 2026	Nga rastet e shqyrtuara për periudhën në fjalë nuk ka rezultuar cenim i lirisë së shprehjes së gazetarëve në media. Gjatë vitit 2025, institucioni i Avokati i Popullit (Seksioni i Administratës) ka shqyrtuar ankesën e paraqitur nga Kryetari i Shoqatës së Gazetarëve të Shqipërisë, lidhur me respektimin e të drejtave të punëmarrësve të shoqërisë mediatike “Ora” sh.a., me NIPT K71505003O, e cila prej datës 06.08.2020 është në pronësi 100% shtetërore. Nga inspektimet e kryera nga Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore për periudhën 2017 – korrik 2025, janë konstatuar shkelje në fushën e marrëdhënieve të punës, në kundërshtim me Kodin e Punës, për të cilat subjektit i janë lënë detyra për	E plote	Falas

		<p>profesionistëve të medias?</p> <ul style="list-style-type: none"> • A keni realizuar raport për vitin 2025 lidhur me të drejtat e gazetarëve dhe nëqoftëse mund të na e vendosni në dispozicion? Cilat janë planet për vitin 2026 lidhur me këtë drejtim. 	<p>përbushje brenda afateve të përcaktuara. Sipas informacionit të përcjellë nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, “Ora” sh.a. rezulton me detyrime tatimore të papaguara dhe ndaj saj janë vendosur 28 masa shtrënguese për periudhën 2021–2025, të cilat do të qëndrojnë në fuqi deri në shlyerjen e plotë të detyrimeve. Në këtë rast nuk janë konstatuar shkelje që të kërkonin ndërhyrjen e Avokatit të Popullit. Po gjatë vitit 2025 janë paraqitur ankesa nga “Focus Media News” sh.p.k. dhe “Panorama Group” sh.a., me pretendime për ndërhyrje të autoriteteve shtetërore përmes heqjes nga posedimi të ambienteve dhe për cenim të lirisë së medias. Për këto ankesa ka nisur hetimi administrativ në përputhje me ligjin nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar. Në kuadër të këtij hetimi janë kërkuar shpjegime dhe dokumentacion zyrtar nga Ministria e Mbrojtjes, Policia Ushtarake, Bashkia Tiranë, Këshilli Bashkiak Tiranë, shoqëria KAYO sh.a. (me kapital 100% shtetëror), Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar. Në mënyrë të veçantë, është paraqitur ankesë nga z. Kino Buxheli, në cilësinë e administratorit të shoqërive të sipërpërmendura, i cili pretendon se më 9 gusht 2025, shoqëria KAYO sh.a., e mbështetur nga punonjës policie, ka nxjerrë me forcë punonjësit e medias News 24 nga ambientet ku ushtronin aktivitetin. Sipas pretendimit, ambientet përdoren mbi bazën e një kontrate me Bashkinë Tiranë, të vlefshme deri në vitin 2033, dhe veprimet janë kryer pa urdhër gjykatë dhe pa praninë e përmbaruesve</p>		
--	--	---	--	--	--

				<p>të autorizuar. Për verifikimin e kësaj ankese është kërkuar informacion nga Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë dhe Policia Ushtarake. Çështja vijon të jetë në shqyrtim dhe ende nuk ka një qëndrim përfundimtar. Sa i takon bashkëpunimit institucional, është konstatuar mungesë bashkëpunimi nga Këshilli Bashkiak Tiranë dhe Bashkia Tiranë, si dhe informacion i paplotë nga Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit dhe KAYO sh.a., ndërsa institucionet e tjera kanë vënë në dispozicion informacionin e kërkuar. Në rastin e “Ora” sh.a., bashkëpunimi ka qenë përgjithësisht korrekt.</p> <p>Për periudhën e kërkuar nuk janë nxjerrë rekomandime dhe gjatë vitit 2025 nuk është hartuar raport i posaçëm. Sa i përket vitit 2026, politikat dhe prioritetet do të vlerësohen në vijimësi, në përputhje me mandatin ligjor të institucionit.</p>		
7	11 shkurt 2026	<p>1. Sa raste të femicidit janë regjistruar zyrtarisht në Shqipëri gjatë 5 viteve të fundit, të ndara sipas vitit, dhe bashkisë?</p> <p>2. Në sa nga rastet e femicidit viktimat kishin bërë më parë ankesa për dhunë në familje?</p> <p>3: Sa prej tyre kishin përfituar urdhra mbrojtjeje ose kishin pasur kontakte të dokumentuara me Policinë e Shtetit apo shërbimet sociale?</p> <p>4. Në sa raste të femicidit është konstatuar dështim institucional, përfshirë mosveprim nga policia e shtetit, reagim të vonuar ose mungesë koordinimi ndërinstytucional?</p> <p>5 A ekziston një përkufizim ligjor i femicidit në legjislacionin</p>	20 shkurt 2026	<p>Avokati i Popullit ka ngritur pranë tij Observatorin për femicidet, prej marsit 2024. Observatori për Femicidet është një mekanizëm monitorimi lidhur me vrasjet e grave/vajzave, me qëllim parandalimin e këtij fenomeni dhe fuqizimin e mekanizmave për mbrojtjen dhe mbështetjen e viktimave të dhunës gra dhe vajza.</p> <p>Ngritja e Observatorit për Femicidet përbën një hap të rëndësishëm në drejtim të institucionalizimit të përpjekjeve për parandalimin e këtij fenomeni dhe për rritjen e nivelit të ndërgjegjësimit të strukturave përgjegjëse në drejtim të trajtimit dhe adresimit të çështjeve të dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje.</p>	E plote	Falas

		<p>shqiptar dhe, nëse jo, sa raste vrasjeje të grave trajtohen aktualisht pa u klasifikuar si femicid, duke ndikuar në statistikat zyrtare dhe politikat publike?</p> <p>6. Sa gra dhe vajza në rrezik të lartë janë aktualisht të identifikuara nga institucionet shtetërore dhe sa struktura strehimi emergjent funksionale ekzistojnë realisht, të ndara sipas qarqeve dhe kapacitetit?</p> <p>7. Në shumicën e rasteve cila ka qene marrëdhënia ndërmjet viktimës dhe autorit?</p>		<p>Shqipëria është vendi i parë në Ballkan dhe ndër të paktat vende në Europë që ka ngritur Observatorin për Femicidet, duke hedhur një hap tepër të rëndësishëm në drejtim të zbatimit të detyrimeve që burojnë nga ratifikimi i instrumentave ndërkombëtare që në përmbajtjen e tyre kanë mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe luftimin e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje.</p> <p>Bazuar në analizimin e të dhënave të mbledhura gjatë vitit 2024 në kuadër të Observatorit, Avokati i Popullit ka hartuar një Raport mbi vrasjet e grave dhe vajzave për periudhën 2021-2023¹. Ky raport u prezantua në konferencën vjetore të Avokatit të Popullit të mbajtur me datën 10 Dhjetor 2024, ditën Ndërkombëtare të të Drejtave të Njeriut.</p> <p>1. Sa raste të femicidit janë regjistruar zyrtarisht në Shqipëri gjatë 5 viteve të fundit, të ndara sipas vitit, dhe bashkisë?</p> <p>Sipas raportit “Vrasje e grave dhe vajzave dhe femicidi, në Shqipëri”, 2021-2023” rezulton se gjatë viteve 2021-2023, në Shqipëri u vranë 32 gra dhe vajza, 27 prej të cilave u vranë nga autorë me të cilët viktimat ishin në marrëdhënie familjare.</p> <p>Rezulton se nga 32 rastet e vrasjeve të grave dhe vajzave, 24 u vlerësuan si femicide, ose vrasje për shkak të gjinisë bazuar në kuadrin statistikor të OKB.</p> <p>Nga 28 autorët e vrasjeve, 26 ishin burra dhe djem dhe në dy raste autore ishin një grua dhe një vajzë. Në 28 raste autori është gjetur dhe</p>		
--	--	--	--	--	--	--

			<p>në dy raste autori nuk është gjetur nga organet kompetente. Gjashtë autorë humbën jetën menjëherë pas ngjarjes, nga të cilët pesë u vetëvranë dhe një humbi jetën në përpjekje për t'iu shmangur arrestimit nga policia. Dy autorë humbën jetën në paraburgim gjatë hetimeve.</p> <p>Në raport do të gjeni të dhëna më të hollësishme.</p> <p>Në javën e parë të marsit pritet të publikohet në faqen zyrtare të Avokatit të Popullit edhe Raporti Vjetor për vitin 2024, nën seksionin raporte të veçanta.</p> <p>Disa të dhëna për vitin 2024:</p> <p>Në ndryshim nga raporti i mëparshëm, raporti i II ka zgjeruar fushën e monitorimit dhe analizës, duke përfshirë, krahas vrasjeve të grave dhe vajzave dhe rasteve të femicidit, edhe forma të tjera të dhunës ekstreme ndaj grave dhe vajzave, të cilat lidhen drejtpërdrejt me dhunën me bazë gjinore.</p> <p>Në këtë kuadër janë marrë në analizë rreth 18 raste, nga të cilat:</p> <ul style="list-style-type: none">- 5 vrasje nga të cilat rezulton se 3 prej këtyre vrasjeve kategorizohen si femicide bazuar në kuadrin statistikor të OKB-së.- 6 raste të vrasjes së mbetur në tentativë,- 3 raste të plagosjes së rëndë me dashje, dhe- 4 raste të shkakimit të vetëvrasjes. <p>Për vitin 2025, të dhënat janë në përpunim dhe një analizë e tyre e thelluar do të jetë e disponueshme në fund të këtij viti.</p> <p>2. Në sa nga rastet e femicidit viktimat</p>	
--	--	--	--	--

				<p>kishin bërë më parë ankesa për dhunë në familje?</p> <p>3. Sa prej tyre kishin përfituar urdhra mbrojtjeje ose kishin pasur kontakte të dokumentuara me Policinë e Shtetit apo shërbimet sociale?</p> <p>Referuar raportit për vitet 2021- 2023:</p> <p>Rezulton se në rreth 90% të rasteve viktimat dhunoheshin nga autorët e vrasjes përpara kryerjes së krimit, por vetëm 6 prej tyre (25%) e kishin raportuar më parë në polici dhunën, dy prej këtyre rasteve ishin të pajisura me masa mbrojtëse (UMM/UM) në momentin e vrasjes, asnjë prej rasteve nuk ishte pajisur me Urdhërin për masat paraprake të Mbrojtjes së Menjëhershme.</p> <p>4. Në sa raste të femicidit është konstatuar dështim institucional, përfshirë mosveprim nga policia e shtetit, reagim të vonuar ose mungesë koordinimi ndërinstytucional?</p> <p>Bazuar në analizën e rasteve, të cilat jepen të detajuara në raportin e cituar më sipër, janë adresuar rekomandime drejtuar insitucioneve përgjegjëse, përfshirë edhe Policinë e Shtetit.</p> <p>Për t'u njohur me rekomandimet përvec në pjesën e raportit REKOMANDIME, ju lutem shihni dhe në link: https://www.avokatipopullit.gov.al/sq/articles/general-issues/e-drejta-e_grave/rekomandime-n-kuadr-t-observatorit-mbi-femicidet-1138/</p> <p>5. A ekziston një përkufizim ligjor i femicidit në legjislacionin shqiptar</p>		
--	--	--	--	--	--	--

				<p>dhe, nëse jo, sa raste vrasjeje të grave trajtohen aktualisht pa u klasifikuar si femicid, duke ndikuar në statistikat zyrtare dhe politikat publike?</p> <p>Femicidi nuk është parashikuar si vepër penale e veçantë në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë. Rastet e vrasjes sipas specifikave që ndjekin, trajtohen në Kreun II, Seksioni I “Krime kundër jetës të kryera me dashje”, në nenet 76, 77, 78, 79 dhe 79/c . Ky element gjinor pasqyrohet vetëm në mënyrë të tërthortë në nenin 50 të Kodit Penal, i cili parashikon motivimin për shkak të gjinisë apo marrëdhënieve familjare si rrethanë rënduese</p> <p>Avokati i Popullit ka adresuar gjatë vitit 2024, një rekomandim drejtuar Minsitrisë së Drejtësisë për “Marrjen e masave për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr.7895, datë 27.01.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar lidhur me parashikimin si vepër penale të femicide/vrasja e grave dhe vajzave², ku kërkohet:</p> <p><i>Marrja e masave për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin Nr.7895, datë 27.01.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar lidhur me parashikimin si vepër penale të femicide/vrasja e grave dhe vajzave, i ndryshuar, si një vepër penale e veçantë, në Kreun II, Seksioni I “Krime kundër jetës të kryera me dashje”.</i></p> <p>Ky rekomandim vjen në përputhje edhe me rekomandimin nr. 24 (a) dhënë nga Komiteti CEDAW pas paraqitjes së raportit V të shtetit në tetor të 2023, i cili i ka rekomanduar shtetit</p>		
--	--	--	--	--	--	--

				<p>shqiptar “Të ndryshojë Kodin Penal për të kriminalizuar posaçërisht femicidin dhe dhunën kibernetike, si edhe për t’i përkufizuar si vepra penale të gjitha format e dhunës me bazë gjinore ndaj grave, përfshirë dhunën fizike, psikologjike, seksuale, ekonomike dhe dhunën në marrëdhëniet familjare”</p> <p>Në kategorizimin si femicid, ne bazohemi në kuadrin statistikor të OKB, sipas të cilit, për qëllime të mbledhjes së të dhënave dhe prodhimit të statistikave, svasjet e grave dhe vajzave të lidhura me gjininë ose Femicidet përkufizohen si: <i>“Vrasje me dashje të grave/vajzave të kryera nga partnerë intimë, nga anëtarë të tjerë të familjes dhe ato të kryera nga persona të tjerë”</i>.</p> <p>Në projekt-Kodin e ri Penal, i cili ndodhet në fazë shqyrtimi, vrasja e grave dhe vajzave për shkak të gjinisë është parashkuar si një nga format e vrasjeve të kryera në rrethana cilësuese, duke përbërë një hap të rëndësishëm drejt adresimit më të plotë të motivimit gjinor si element penalisht i rëndësishëm.</p> <p>6. Sa gra dhe vajza në rrezik të lartë janë aktualisht të identifikuara nga institucionet shtetërore dhe sa struktura strehimi emergjent funksionale ekzistojnë realisht, të ndara sipas qarqeve dhe kapacitetit?</p> <p>-Për të dhëna lidhur me rastet e grave dhe vajzave të idendifikuara në rrezik, ju mund t’i drejtoheni Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Bashkive të vendit, pranë të cilave funksionojnë Mekanizmat e Koordinur të referimit, si dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, si autoriteti kryesor përgjegjës për çështjet e barazisë gjinore dhe</p>		
--	--	--	--	--	--	--

				<p>dhunës ndaj grave, që ka dhe detyrimin ligjor për mbajtjen e statistikave.</p> <p>Po kështu një burim i të dhënave është edhe Botimi Burra dhe Gra në Shqipëri, botim vjetor statistikor i INSTAT, raporte të cilat i gjeni në faqen zyrtare të këtij institucioni.</p> <ul style="list-style-type: none">- Lidhur me Strehëzat emergjente, Avokati i Popullit në kuadër të tagrit të tij monitorues, bën inspektime në qendrat/strehëzat emergjente për viktimat e dhunës në familje, lidhur me respektimin e standardeve të miratuara. <p>Për të dhëna lidhur me sa struktura strehimi emergjent funksionale ekzistojnë realisht, ju mund t'i drejtoheni Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Shërbimit Social Shtetëror dhe Inspektoriatit Shtetëror për Shërbimet Shoqërore.</p> <p>Për inspektimet, ju mund të gjeni informacion në raportet vjetore të Avokatit të Popullit nën seksionin Barazia gjinore dhe dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje.</p> <p>Në mënyrë të përmbledhur për rekomandimet të cilat adresohen:</p> <p>Avokati i Popullit , ndërsa vlerëson të gjitha përpjekjet dhe masat e ndërmarra nga Qeveria dhe Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore, për t'u përgjigjur nevojave të viktimave të dhunës me shërbime të specializuara duke alokuar gjithashtu fonde nëpërmjet Mekanizmit të Fondit Social, vijon të konstatojë se këto shërbime kërkojnë përmirësim thelbësor. Është e nevojshme të zgjerohet gama e shërbimeve të ofruara, të sigurohet shtrirja e tyre në të gjithë territorin e vendit, duke i bërë ato të aksesueshme dhe të arritshme për të gjitha grupet e grave, së bashku me fëmijët e tyre, si dhe të përshtaten për të përmbushur</p>	
--	--	--	--	--	--

				<p>nevojat specifike të personave me aftësi të kufizuara. Po ashtu, një rigrupim i shërbimeve në baza më të gjera territoriale mund të lejojte efektivitet dhe cilësi të tyre.</p> <p>7. Në shumicën e rasteve cila ka qene marrëdhënia ndërmjet viktimës dhe autorit?</p> <p>Lidhur me këto të dhëna ju lutem referojuni raportit 2021-2023, dhe për vitin 2024 pas publikimit të tij në faqen zyrtare të Avokatit të Popullit.</p> <p>Të tjera:</p> <p>Për informacione të tjera, lidhur me dhunën ndaj grave apo çështje të drejtave të grave, sugjerojmë të shihni raportet vjetore të Avokatit të Popullit si dhe raportet speciale, të cilat i gjeni të publikuara në faqen zyrtare të institucionit.</p>		
8	17 shkurt 2026	<ol style="list-style-type: none"> 1. A mund të hetojnë prokurorë dhe gjyqtarë veten apo kolegët e tyre të drejtpërdrejtë? 2. A lejohet ligjërisht që një prokurori rrethi të hetojë prokurorë dhe gjyqtarë të po atij rrethi? 3. Pse SPAK nuk e delegoi drejtpërdrejt çështjen në një rreth tjetër? 4. A përbën ky transferim rrezik për prishje provash dhe njohje paraprake të provave nga persona potencialisht të implikuar? 5. A duhet të ndërhyjë Prokuroria e Përgjithshme për të zgjidhur konfliktin institucional të kompetencës? 6. Informacion zyrtar mbi datën e regjistrimit të procedimit penal pas delegimit nga SPAK të dosjes në Prokurorinë e Juridiksionit Vlorë? 7. Vendimin dhe bazën ligjore të kalimit të dosjes nga Vlora në Fier dhe mbi çfarë baze ligjore?. 8. Sqarim nëse kjo procedurë cenon parimin e paanshmërisë dhe konfliktin e interesit 9. Ndërhyrjen e Prokurorisë së Përgjithshme për delegimin e çështjes në një juridiksion tjetër neutral. 	19 shkurt 2026	<p>Institucioni i Avokatit të Popullit ka administruar ankesën e këtij shtetasi në datën 10.02.2026. Ajo çfarë ankuesi kërkon nga Avokati i Popullit shkruar dhe në ankesë, konfirmuar dhe me komunikim me telefon, është mungesa e informacionit nga ana e organit të prokurorisë Vlorë lidhur me datën e regjistrimit të kallëzimit penal nr. 34./2026 dhe datën kur fashikulli penal ka ardhur nga SPAK dhe është regjistruar në këtë prokurori.</p> <p>Ankuesi shprehet në ankesë se në datën 22 dhjetor 2025, ka dërguar në rrugë postare një kallëzim penal në vlerësim të Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (SPAK). Në janar 2026 është njoftuar nga ky organ se ky kallëzim penal i</p>	E plote	Falas

		<p>10. Qëndrim zyrtar nga KLP mbi përgjegjësinë disiplinore të mundshme.</p> <p>11. Qëndrim nga Avokati i Popullit mbi cenimin e të drejtave themelore të qytetarit.</p>		<p>është përcjellë për vlerësim Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, pasi është vlerësuar se nuk përfshihet në kompetencën lëndore të SPAK.</p> <p><u><i>(Për sa kohë flitet për gjyqtarë dhe prokurorë që e ushtronin detyrën e tyre në Fier, SPAK e a përcjellë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, duke u bazuar në parimin e paanshmërisë, shmangien e konfliktit të interesit dhe në parashikimet e nenet 75/a dhe 78 të Kodit të Procedurës Penale, si dhe ligjin nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”).</i></u></p> <p>Me marrjen e këtij njoftimi ankuesi ka kërkuar informacion pranë organit të prokurorisë Vlorë për tu njohur me datën kur është regjistruar ky kallëzim në regjistrin e kallëzimeve penale të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, por nuk ka marrë informacion.</p> <p>Po ashtu, thekson se mospërgjigja e organit të prokurorisë dhe pas kërkesë zyrtare, për tu njohur me këto të dhëna të kallëzimit penal ka cënuar të drejtat themelore, si e drejta për informim dhe e drejta për një proces të rregullt ligjor.</p> <p>Pasi u njohëm me ankesën, referuar nenit 13, paragrafi i parë, të ligjit nr.8485, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, në të cilin parashikohet se: “Avokati i Popullit fillon procedurën e shqyrtimit të çështjes kur vëren ose dyshon se</p>		
--	--	--	--	---	--	--

				<p>ka ndodhur një shkelje e së drejtës, në bazë të ankesës apo të kërkesës së personit të interesuar ose të dëmtuar, si dhe me nismën e vet, për raste të veçanta të bëra publike”, vlerësuam se ajo përmban elemente për t’u pranuar për shqyrtim nga ana e institucionit tonë.</p> <p>Për shqyrtimin e saj me shkresën tonë nr. K2/S10-3Prot dt. 16.02.2026 “Kërkesë për informacion” i jemi drejtuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Vlorë, për të na informuar lidhur me rastin në fjalë. Jemi në pritje të një përgjigje prej tyre.</p> <p><u>Rasti është në ndjekje nga Avokati i Popullit përsa i përket cënimit të të drejtave për të cilat është adresuar kjo kërkesë pranë institucionit tonë.</u></p>		
9	19 shkurt 2026	<p>Me propozim të Kryeministrit Edi Rama, ka propozuar një ndryshim në nenin 242 të Kodit të Procedurës Penale, përmes të cilit synohet zgjerimi i listës së posteve kushtetuese që nuk mund të pezullohen nga gjykata nga detyra apo shërbimi publik që kryejnë.</p> <p>Përveç personave të zgjedhur sipas ligjit elektoral, në këtë listë parashikohet të përfshihen edhe Presidenti, Kryeministri, zëvendëskryeministri, ministrat, Avokati i Popullit, Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit si dhe anëtarët e Gjykatës Kushtetuese.</p> <p>Duke qenë se institucioni që ju drejtoni preket drejtpërdrejt nga ky ndryshim i propozuar, do të vlerësonim një përgjigje nga ana juaj për këto çështje:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. A e mbështet Avokati i Popullit këtë nismë ligjore? 2. Cili është vlerësimi juaj mbi ndikimin që mund të ketë ky ndryshim në parimin e barazisë para ligjit dhe në 	02 mars 2026	<p>Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion, ju bëjmë me dije se pranë institucionit të Avokatit të Popullit nuk është administruar ende asnjë propozim zyrtar apo projektligj nga qeveria lidhur me çështjen e imunitetit të Avokatit të Popullit.</p> <p>Siç jeni në dijeni, garancitë e ushtrimit të mandatit të Avokatit të Popullit, përfshirë imunitetin, janë të sanksionuara qartë në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë si një element thelbësor për mbrojtjen e pavarësisë së institucionit. Për shkak të kësaj rëndësie dhe natyrës së punës sonë, çdo qëndrim institucional kërkon një analizë rigoroze të dokumentacionit përfundimtar dhe relacioneve shpjeguese bashkëngjitur.</p> <p>Diskutimet mediatike në fazat e hershme, ndonëse të rëndësishme, përfaqësojnë një moment ku idetë mund të pësojnë ndryshime dhe nuk ofrojnë bazën e nevojshme për një</p>	E plote	Falas

		funksionimin e shtetit të së drejtës?		vlerësim objektiv. Për këtë arsye, sapo të njihemi zyrtarisht me tekstin e plotë dhe përfundimtar të kësaj nisme, institucioni do ta shqyrtojë atë me vëmendjen e duhur dhe do të bëjë publik qëndrimin e tij.		
10	20 shkurt 2026	<p>1. Proceset e emërimit / zgjedhjes</p> <ul style="list-style-type: none"> · Lista e pozicioneve vakante ne nivelin e mesëm dhe të lartë ose të shpallura për konkurrim nga data 01.09.2025 e në vijim që janë subjekt i ligjit 138/2015. <p>2. Transparenca e kandidatëve/të emëruave/zgjedhurve:</p> <ul style="list-style-type: none"> · Nëse ka raste, kërkojmë nëse CV-të e kandidatëve janë publike. <p>3. Masa administrative në zbatim të Ligjit nr. 138/2015: Gjithashtu, kërkojmë informacion nëse, gjatë periudhës 01.09.2025 – në vijim, Institucioni juaj ka marrë masa administrative në zbatim të Ligjit nr. 138/2015, ndaj zyrtarëve të zgjedhur, të emëruar apo stafit drejtues. Për secilin rast (nëse ka), kërkojmë të informohemi mbi:</p> <ul style="list-style-type: none"> · funksionin/pozicionin; llojin e masës administrative dhe datën e vendimit; <p><i>Sqarojmë se kërkesa nuk synon marrjen e të dhënave penale personale apo informacione mbi hetime penale në zhvillim, por vetëm informacion mbi vendimmarrjen dhe pasojat administrative institucionale, në përputhje me legjislacionin në fuqi.</i></p>	20 shkurt 2026	<p>1. Proceset e emërimit / përzgjedhjes</p> <ul style="list-style-type: none"> - Lista e pozicioneve vakante ose të shpallura për konkurrim nga data 01.09.2025 e në vijim; - 1 pozicion <i>Ndihmes Komisioner ne Seksionin (Mekanizmi per Parandalimin e Tortures, Trajtimin ose Denimit te Eger, Cnjerezor ose Poshterues) – Nivel i Larte Drejtues</i> - 2 pozicione <i>Komisioner (1 pozicion Komisioner ne Seksionin Mekanizmi per Parandalimin e Tortures, Trajtimin ose Denimit te Eger, Cnjerezor ose Poshterues dhe 1 pozicion ne Seksionin Per Mbrojtjen dhe Promovimin e te Drejtave te Femijeve) – Te Zgjedhur</i> <p>- Datat e hapjes së thirrjeve publike;</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. <i>Ky pozicion vakant eshte shpallur ne date 02.12.2025</i> 2. <i>Pozicionet jane shpallur ne date 20.01.2026</i> <p>- Faza aktuale e secilit proces;</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. <i>Procedura ka perfunduar procedura pa candidate fitues.</i> 2. <i>Procedura eshte ende ne afatet e aplikimit per pozicionet vakante.</i> <p>- Strukturat/organet institucionale të përfshira;</p> <p>Linku:</p>	E plote	Falas

			<p>https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/Ndryshim%20i%20strukturas%20organizative%2013.01.2025.PDF</p> <p>- Kriteret ligjore dhe procedurale të përzgjedhjes;</p> <p>1. linku:</p> <p>https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/Shpallje%20pozicioni%20vakant.MKPT.%20TND.%20Dhjetor%202025.pdf</p> <p>2. linku:</p> <p>https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/media/NJOFTIM%20PER%20SHPALLJEN%20E%20DY%20VENDEVE%20OVAKANT%20PER%20KOMISIONER.pdf</p> <p>- Afatet e parashikuara për përfundimin e proceseve dhe plotësimin e vendeve vakante.</p> <p>1. <i>procedura ka përfunduar pa candidate fitues, ne zbatim te legjislacionit, pritet rishpallja e tij</i></p> <p>2. <i>Ne varesi te kushteve ligjore (aplikimeve; zgjatje afati; deri ne votim nga Kuvendi)</i>³</p> <p>2. Transparenca e kandidatëve</p> <p>- Nëse CV-të dhe dokumentacioni profesional i kandidatëve janë publike; - <i>JO</i></p> <p>- Nëse po, ku mund të aksesohen;</p> <p>- Nëse jo, baza ligjore për mosbërjen publike të tyre. – <i>CV behen publike vetem ne</i></p>	
--	--	--	--	--

				<p><i>momentin e perzgjedhjes ne detyre</i></p> <p>3. Masa administrative në zbatim të Ligjit nr. 138/2015 Gjithashtu, kërkojmë informacion nëse, gjatë periudhës 01.09.2025 – në vijim, Avokati i Popullit, ka marrë masa administrative në zbatim të Ligjit nr. 138/2015, ndaj zyrtarëve të zgjedhur, të emëruar apo stafit drejtues. - <i>JO</i></p> <p>Për secilin rast (nëse ka), kërkojmë të informohemi mbi:</p> <ul style="list-style-type: none"> - funksionin/pozicionin; - llojin e masës administrative; - datën e vendimit; - organin kompetent vendimmarrës; - referencën ligjore përkatëse. 		
11	Elvis Boci, I denuar, përfaqësuar nga av.Klodiana Gjyzari	<ul style="list-style-type: none"> - A ka patur ankesa nga banorë të fshatit Lazarat, Gjirokastër, pranë Avokatit të Popullit për ushtrimin e dhunës policore, apo veprimeve arbitrare nga policia e shtetit, gjatë veprimeve hetimore apo procedurale në lidhje me ngjarjen e ndodhur në datën 24.06.2015 në Lazarat, gjatë së cilës humbi jetën i ndjeri z.Ibrahim Basha, punonjës i policisë së shtetit. - A ka patur ankesa nga shtetasit Klodian Selimi, Elson Kazma, Oltian Proko, Dervish Gaba, Xhulio Malo, Alban Aliko, Arbjon Aliko, Elvis Boci, Ruhan Hiraj, apo të afërm të tyre, për ushtrim të dhunës policore, apo veprimeve arbitrare nga policia e shtetit, gjatë veprimeve hetimore apo procedurale në lidhje me ngjarjen e ndodhur në datën 24.06.2015 në Lazarat, gjatë së cilës humbi jetën i ndjeri z.Ibrahim Basha, punonjës i policisë së shtetit. 	19 Mars 2026	<p>Në përgjigje të kërkesës tuaj, ju informojmë se në muajin korrik 2025, institucioni i Avokatit të Popullit ka kryer takime në fshatin Lazarat të Gjirokastrës, me banorë të kësaj zone, për të marrë ankesat e tyre mbi problematikat që shqetësojnë këtë komunitet banorësh dhe që lidhen me respektimin e të drejtave të njeriut. Këto takime janë zhvilluar pas ngjarjes së muajit qershor 2015, ku në fshatin Lazarat, të Gjirokastrës, është zhvilluar një operacion policor për kapjen e autorëve të vrasjes së punonjësit të Forcave Speciale “Renea”.</p> <p>Avokati i Popullit ka administruar ankesat respektive të banorëve, si dhe ka iniciuar ndjekjen e shqetësimeve të parashtruar nga</p>	E plote	Falas

		<p>- A ka patur hetime nga Avokati i Popullit në lidhje me pretendime për veprime arbitrare nga policia e shtetit, nëse po cili ka qënë rezultati i procesit hetimor.</p>		<p>ana e tyre, të fokusuar konkretisht në këto fusha:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Keqtrajtimi nga punonjësit e policisë të Strukturave Speciale Operacionale, në dëm të disa shtetasve, banues në Lazarat të Gjirokastrës. Mbi këtë shqetësim është urdhëruar kryerja e një hetimi të pavarur administrativ, në përfundim të të cilit i është rekomanduar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë fillimi i hetimit për veprën penale “Kryerja e veprimeve arbitrare”, parashikuar nga neni 250 e 25 i Kodit Penal. Në përgjigje të rekomandimit të Avokatit të Popullit, jemi informuar se kishte filluar hetimi nga ana e strukturave të Prokurorisë. - Faturimet aforfe për të cilat i është rekomanduar strukturave të OSHEE-së marrja e masave të menjëhershme, për instalimin e matësve të energjisë elektrike për çdo abonent, që në të ardhmen konsumatori të mos paguajë më faturimeve aforfe. - Probleme me furnizimin me ujë të pijshëm dhe faturimin aforfe të tij. Lidhur me këtë shqetësim, Avokati i Popullit i ka rekomanduar Kryetares së Bashkisë Gjirokastrë marrjen e masave të menjëhershme për furnizim normal me ujë të pijshëm, si edhe instalimin e matësve të konsumit të ujit për çdo abonent, me qëllim që të shmangen faturimet 		
--	--	---	--	--	--	--

				<p>aforfe.</p> <ul style="list-style-type: none">- Problemi i funksionimit të sistemeve të kullimit dhe vaditjes së tokave në sektorin e bujqësisë duke shkaktuar në këtë mënyrë edhe mangësi në shfrytëzimin efikas dhe me rendiment të tokës buqësore. Avokati i Popullit ka hartuar një rekomandim drejtuar strukturave të Bordit të Kullimit dhe Drejtorisë së Bujqësisë në Gjirokastrë, me qëllim që të merren masa për përmirësimin e sistemeve të vaditjes dhe kullimit, si edhe ofrimin e programeve mbështetëse në këtë fushë.- Një nga çështjet me rëndësi ishte dhe arsimimi i fëmijëve të fshatit. Banorët vetë janë shprehur se shkollat kanë infrastrukturën e nevojshme si dhe stafin pedagogjik, por kishte mungesë psikologësh në shkolla, roli i të cilit është mjaft i rëndësishëm duke ditur situatën dhe kushtet ku kanë jetuar këta fëmijë. Sa më sipër ne i rekomanduam Ministrisë së Arsimit dhe Sportit marrjen e masave për caktimin e një psikologu, ose punonjësi social në shkollat e fshatit Lazarat, Gjirokastrë, për vitin shkollor 2015-2016 e në vazhdim.- Gjithashtu, problematikë tjetër ishte edhe shërbimi shëndetësor në këtë zonë. Banorët u janë shprehur se qendra shëndetësore nuk kishte kushte të përshtatshme, kishte vetëm një mjek për komunën, i cili nuk punonte me kohë të plotë.		
--	--	--	--	--	--	--

				<p>Gjithashtu, mungonte shërbimi dentar dhe farmaceutik në këtë komunë. Për këtë, Avokati i Popullit kërkoi shpjegime nga Ministria e Shëndetësisë dhe DRSH-ja Gjirokastër, të cilët e pranuan realitetin dhe u angazhuan për zgjidhjen e problematikës.</p> <p>Informacionin e lartpërmendur e gjeni në faqen tonë zyrtare⁴, në rubrikën botime/raporte vjetore, më konkretisht, në Raportin Vjetor 2015⁵, fq. 16, 45, 52, 69, 74, 129, 130.</p>		
12	2 Prill 2026	<p>Nga raportimet zyrtare, shtetasi Sefedin Shefa ka bërë një ankesë pranë institucionit të Avokatit të Popullit në mars 2026. Në kuadër të transparencës publike, duke u bazuar tek ligji nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, i ndryshuar, redaksia e emisionit “Vetting” kërkon si informacion:</p> <p>1. Cilat janë rekomandimet e dhëna në këtë rast nga institucioni juaj përsa i përket problematikës së çështjes?</p> <p>Ju lutemi, të na vendosni në dispozicion një kopje të rekomandimeve që keni dhënë për këtë çështje ndaj institucioneve që duhet të zbatojnë legjislacionin përkatës.</p>	7 Prill 2026	<p>Lidhur me këtë rast ju kemi informuar dhe më herët në datën 17.02.2026, informacionin e disponueshëm deri në atë kohë për këtë ankesë. Pas kësaj date ne kemi marrë një përgjigje nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë dhe bazuar në këtë përgjigje si dhe në kopjen e dokumentacionit referues, i kemi kthyer përgjigje me shkrim ankuesit në datën 06.03.2026. Në përgjigjen e prokurorisë referoheshin shkresat me anë të së cilës ishte bërë me dije ankuesi si dhe i ishte përcjellë informacioni I kërkuar. (mungesa e informacionit ishte dhe objekti i ankesës së qytetarit)</p> <p>Përsa i përket vendimmarrjes së prokurorisë për moskompetencë, bazuar në nenet 76 dhe 78 "Kompetenca për procedimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve" i Kodit të Procedurës Penale, Avokati i Popullit nuk ka kompetencë të gjykojë vendimet e Organit të Prokurorisë</p>	E plote	Falas

⁴ www.avokatipopullit.gov.al

⁵ www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/reports/RAPORTI%202015.pdf

				<p>apo të Gjykatës. Këtë sqarim e kemi bërë dhe gjatë takimit të ankuesit në zyrën e Komisionerit të Seksionit të Veçantë të Avokatit të Popullit.</p> <p>Institucioni i Avokatit të Popullit nuk ka të drejtë të ndikojë organet e drejtësisë lidhur me veprimtarinë e tyre gjatë hetimit apo shqyrtimit të një çështje penale apo civile apo të gjykojë një vendim të prokurorisë apo gjykatës. Gjykata dhe Prokuroria janë të pavarura në vendimmarrjen e tyre.</p> <p>Pavarësia e gjyqtarëve dhe prokurorëve gjatë ushtrimit të detyrës parashikohet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, më konkretisht në nenin 145, pika 1 ku përcaktohet se: <i>“Gjyqtarët janë të pavarur dhe u nënshtrohen vetëm Kushtetutës dhe ligjeve”</i> dhe neni 148 pika 2 <i>“Prokuroria është organ i pavarur që garanton mbarëvajtjen, kontrollin e veprimeve të saj dhe respekton pavarësinë e brendshme të prokurorëve për hetimin dhe ndjekjen penale, sipas ligjit”</i>.</p> <p>Referuar nenit 25 <i>“Personat dhe aktet jashtë juridiksionit të Avokatit të Popullit”</i> të Ligjit Nr.8454, datë 04.02.1999 <i>“Për Avokatin e Popullit”</i>, i ndryshuar, përcaktohet se; <i>“Avokati i Popullit pranon ankesa, kërkesa ose njoftime për shkelje të të drejtave të njeriut, që rrjedhin nga administrata e pushtetit gjyqësor, dhe ekzekutimi i vendimeve gjyqësore. Hetimi dhe kërkesa e Avokatit të Popullit nuk prekin pavarësinë e gjykatës në marrjen e vendimit”</i>.</p>		
13	21 Prill 2026	<ol style="list-style-type: none"> 1. Numri total i ankesave të regjistruara në institucionin tuaj që lidhen me intervistimet nga organet e zbatimit të ligjit, për periudhën 2019–2025. 2. Klasifikimi i këtyre ankesave sipas llojit të shkeljes së pretenduar, nëse disponohet, si p.sh.: <ul style="list-style-type: none"> ○ presion psikologjik gjatë intervistimit; 	30 Prill 2026	Me <i>“Kërkesën për informacion”</i> të datës 21.04.2026, të paraqitur në institucionin e Avokatit të Popullit, në bazë të Ligjit nr. 119/2014 <i>“Për</i>	E plotë	Falas

		<ul style="list-style-type: none"> ○ marrje deklarimesh në kushte të papërshtatshme; ○ mosrespektim i të drejtës për mbrojtje; ○ trajtim i papërshtatshëm gjatë intervistimit. <p>3. Dokumentet ose formatet në të cilat regjistrohen dhe dokumentohen këto ankesa (p.sh. regjistër ankesash, raporte verifikimi, shkresa zyrtare).</p> <p>4. Në bazë të ankesave të trajtuara, cilat janë strukturat përgjegjëse në Policinë e Shtetit dhe/ose Prokurori për zhvillimin, mbikëqyrjen e intervistimeve dhe trajtimin e ankesave përkatëse?</p> <p>5. Rezultati i trajtimit të ankesave, sipas kategorive (nëse disponohet), si p.sh.:</p> <ul style="list-style-type: none"> ○ ankesa të pranuar si të bazuara; ○ ankesa të rrëzuara; ○ rekomandime të dhëna; ○ masa të ndërmarra ose referime në institucione të tjera. <p>6. Procedurat ekzistuese për paraqitjen e ankesave nga individët që pretendojnë shkelje gjatë intervistimit (p.sh. mënyra e depozitimit, afatet dhe forma e shqyrtimit).</p> <p>7. Mënyra se si dokumentohen shkeljet e pretenduara gjatë intervistimit nga institucioni juaj.</p> <p>8. Çdo raport, rekomandim ose dokument zyrtar i nxjerrë nga institucioni juaj gjatë periudhës 2019–2025 që lidhet me:</p> <ul style="list-style-type: none"> ○ praktikat e intervistimit; <p>respektimin e të drejtave të personave gjatë intervistimit.</p>		<p><i>të drejtën e Informimit</i>”, të ndryshuar, ju keni kërkuar informacion lidhur me ankesat për mënyrën e zhvillimit të intervistimeve nga organet e zbatimit të ligjit (Policia e Shtetit dhe/ose Prokuroria), për periudhën 2019–2025.</p> <p>Më konkretisht ju kërkoni sa më poshtë vijon:</p> <p><i>1. Numri total i ankesave të regjistruara në institucionin e Avokatit të Popullit që lidhen me intervistimet nga organet e zbatimit të ligjit, për periudhën 2019–2025.</i></p> <p><i>2. Klasifikimi i këtyre ankesave sipas llojit të shkeljes së pretenduar, nëse disponohet, si p.sh.:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> ○ <i>presion psikologjik gjatë intervistimit;</i> ○ <i>marrje deklarimesh në kushte të</i> 		
--	--	--	--	---	--	--

				<p><i>papërshtatshme;</i></p> <ul style="list-style-type: none"> ○ <i>mosrespektim i të drejtës për mbrojtje;</i> ○ <i>trajtim i papërshtatshëm gjatë intervistimit.</i> <p>3. <i>Dokumentet ose formatet në të cilat regjistrohen dhe dokumentohen këto ankesa (p.sh. regjistër ankesash, raporte verifikimi, shkresa zyrtare).</i></p> <p>4. <i>Në bazë të ankesave të trajtuara, cilat janë strukturat përgjegjëse në Policinë e Shtetit dhe/ose Prokurori për zhvillimin, mbikëqyrjen e intervistimeve dhe trajtimin e ankesave përkatëse?</i></p> <p>5. <i>Rezultati i trajtimit të ankesave, sipas kategorive (nëse disponohet), si p.sh.:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> ○ <i>ankesa të pranuar si të bazuara;</i> ○ <i>ankesa të rrëzuara;</i> ○ <i>rekomandime të</i> 	
--	--	--	--	---	--

				<p><i>dhëna;</i></p> <ul style="list-style-type: none"> ○ <i>masa të ndërmarra ose referime në institucione të tjera.</i> <p>6. <i>Procedurat ekzistuese për paraqitjen e ankesave nga individët që pretendojnë shkelje gjatë intervistimit (p.sh. mënyra e depozitimit, afatet dhe forma e shqyrtimit).</i></p> <p>7. <i>Mënyra se si dokumentohen shkeljet e pretenduara gjatë intervistimit nga institucioni i Avokatit të Popullit.</i></p> <p>8. <i>Çdo raport, rekomandim ose dokument zyrtar i nxjerrë nga institucioni i Avokatit të Popullit gjatë periudhës 2019–2025 që lidhet me:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> ○ <i>praktikat e intervistimit;</i> ○ <i>respektimin e të drejtave të personave gjatë</i> 	
--	--	--	--	---	--

				<p><i>intervistimit.</i></p> <p>Ky informacion kërkohet nga ana juaj për t'u përdorur për qëllime akademike, në kuadër të punimit të diplomës në Master Ekzekutiv në Kriminologji, pranë Universitetit të Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë</p> <p>Në përgjigje të kërkesës tuaj, ju informojmë se:</p> <p>Respektimi i drejtave të personave të shoqëruar në komisariatet e policisë, është një fushë e së drejtës që mbikëqyret nga Seksioni për policinë, shërbimin sekret, burgjet, Forcat e Armatosura dhe pushtetin gjyqësor (Seksioni i Veçantë) si dhe nga Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës, Trajtimit ose Dënimit të Egër, Çnjerëzor ose Poshtëruar (MKPT-ja). Këto janë dy nga pesë seksionit që funksionojnë në institucionin e Avokatit të Popullit, të specializuar sipas fushave përkatëse. Në ndryshim nga MKPT-ja, e cila kryen inspektime</p>		
--	--	--	--	--	--	--

			<p>periodike në institucionet e privimit të lirisë (ku bëjnë pjesë edhe mjediset e komisariateve të policisë), Seksioni për policinë, shërbimin sekret, burgjet, Forcat e Armatosura dhe pushtetin gjyqësor merr në shqyrtim ankesat individuale që kanë të bëjnë me respektimin e të drejtave të personave të privuar nga liria.</p> <p>Qytetarët mund të na janë drejtohen me ankesë duke u paraqitur vetë ose nëpërmjet familjarit/përfaqësuesit ligjor në zyrën e pritjes së institucionit të Avokatit të Popullit, nëpërmjet shërbimit postar, postës elektronike, aplikacionit në faqen zyrtare si dhe kur është marrë takim me ta, gjatë kohës që ndodheshin të shoqëruar/ndaluar në mjediset e komisariateve të policisë/drejtorive vendore të policisë.</p> <p>Gjithashtu, bazuar në nenin 13, paragrafi i parë, i Ligjit nr.8485,</p>		
--	--	--	---	--	--

			<p>datë 04.02.1999 “<i>Për Avokatin e Popullit</i>”, Avokati i Popullit fillon procedurën e shqyrtimit të çështjes dhe me nismën e vet, për raste të veçanta të bëra publike.</p> <p>Në rastet kur ankesa merret nga një përfaqësues i institucionit të Avokatit të Popullit, plotësohet formulari tip që përdor institucioni për marrjen e ankesave (bashkëlidhur këtij informacioni do të gjeni formularin tip).</p> <p>Ankesa e paraqitur në një nga mënyrat e lartpërmendura regjistrohet nga zyra e protokollit në një regjistër fizik si dhe në sistemin elektronik që përdor institucioni për regjistrimin e ankesë/kërkesave. Në vijim ankesa i caktohet për shqyrtim një ndihmëskomisioneri sipas fushës që ai mbulon dhe ai kryen veprimet verifikuese që mund të përfshijnë: hartimin e shkresave; administrimin e dokumentacionit; këqyrje të mjediseve të</p>		
--	--	--	---	--	--

				<p>institucioneve publike; fotografimi i mjediseve të institucioneve publike; intervistim të punonjësve të administratës publike; intervistim të personave që lidhen me çështjen⁶. (Kur merren deklarime nga një person që ka lidhje me ngjarjen apo nga një shtetas, plotësohet procesverbali tip bashkëlidhur këtij informacioni)</p> <p>Kur hetimi administrativ konsiderohet i përfunduar, analizohet legjislacioni dhe faktet e mbledhura dhe dilet me një nga qëndrimet e parashikuara në nenin 21 të Ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “<i>Për Avokatin e Popullit</i>”.</p> <p>Presioni psikologjik i ushtruar nga punonjësit e policisë gjatë intervistimit të një qytetari është i vështirë për t’u provuar, për arsye se dhuna psikologjike kryhet në vende të mbyllura, brenda</p>		
--	--	--	--	--	--	--

⁶ Neni 19, 19/1 dhe 20 i Ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “*Për Avokatin e Popullit*”.

				<p>ambienteve të policisë në zyra, pa dëshmitarë. Edhe në rastet kur ka dëshmitarë, shpesh ata hezitojnë të denoncojnë punonjësit e policisë.</p> <p>Në faqen tonë zyrtare⁷ gjenden të botuara raportet vjetore, në rubrikën botime/raporte vjetore⁸, ku përmbledhet puna e institucionit të Avokatit të Popullit për çdo vit të funksionimit të tij.</p> <p>Për sa i përket kërkesës tuaj për numrin total të ankesave të regjistruara në institucionin e Avokatit të Popullit që lidhen me intervistimet nga organet e zbatimit të ligjit, për periudhën 2019–2025, ju bëjmë me dije se kjo e dhënë nuk është mbajtur nga ana jonë.</p>	
--	--	--	--	---	--

⁷ www.avokatipopullit.gov.al

⁸ <https://www.avokatipopullit.gov.al/sq/list/publications/rraporte-vjetore-2/>

				<p>Raporti Vjetor 2019</p> <p>Në raportin vjetor për vitin 2019⁹, fq. 43, pika 6, është raportuar si problematikë e konstatuar nga MKPT-ja gjatë inspektimit të komisariateve të policisë, mungesa e kamerave në korridoret e dhomave të shoqërimit, sigurisë dhe ambientet e marrjes në pyetje të shtetasve.</p> <p>Në faqen 30 të Raportit Vjetor për vitin 2019, gjenden konstatimet tona pasi kemi përfunduar hetimin administrativ të rastit të bërë publik nga media, mbi veprimet e kundërligjshme të punnjësve të policisë ndaj disa personave të shoqëruar në mjediset e komisarariatit, ku ndër të tjera, ka rezultuar dhunimi fizik e psikologjik i të shoqëruarve.</p>		
--	--	--	--	---	--	--

⁹ <https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/reports/Raporti%20Vjetor%202019%20-%20Avokati%20i%20Popullit.pdf>

				<p>Raporti Vjetor 2020</p> <p>Në raportin vjetor për vitin 2020¹⁰, fq. 49, pika 6, është raportuar si problematikë e konstatuar nga MKPT-ja gjatë inspektimit të komisariateve të policisë, mungesa e kamerave në korridoret e dhomave të shoqërimit, sigurisë dhe ambientet e marrjes në pyetje të shtetasve.</p> <p>Në faqen 120 të Raportit Vjetor për vitin 2020, gjenden konstatimet tona nga monitorimi i ambienteve të komisariateve, që kanë të bëjnë edhe me marrjen në pyetje të personave të shoqëruar.</p> <p>Raporti Vjetor 2021</p> <p>Në raportin vjetor për vitin 2021¹¹, fq. 43 (paragrafi i pare) dhe fq.55 (paragrafi i pare) është raportuar si</p>		
--	--	--	--	--	--	--

¹⁰<https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/reports/Raporti%20Vjetor%20i%20veprimtarise%20se%20institucionit%20te%20Avokatit%20te%20Popullit%20-%20viti%202020.pdf>

¹¹<https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/reports/Raporti%20vjetor%20i%20verpimtaris%C3%AB%20s%C3%AB%20institucionit%20t%C3%AB%20AP%20p%C3%ABr%20vitin%202021.pdf>

				<p>problematikë e konstatuar nga MKPT-ja gjatë inspektimit të komisariateve të policisë:</p> <ul style="list-style-type: none">- Fleta shpjeguese me të drejtat e personave të ndaluar u jepet atyre në fund të procesit të marrjes në pyetje.- Mungesa e kamerave në korridoret e dhomave të shoqërimit, sigurisë dhe ambientet e marrjes në pyetje të shtetasve. <p>Ndërsa, në fq. 55 (paragrafi i fundit) dhe fq. 56 (paragrafi i pare) të Raportit Vjetor 2020, gjenden të dhëna mbi përshtatjen dhe pajisjen e ambienteve në strukturat vendore të policisë, për intervistimin e të miturve.</p>		
--	--	--	--	--	--	--

				<p>Raporti Vjetor 2022</p> <p>Në raportin vjetor për vitin 2022¹², fq. 53 (paragrafi i fundit) raportohet se MKPT ka konstatuar përsëri se personat e shoqëruar/ndaluar nga punonjësit e policisë nënshkruajnë deklaratën që vërteton se morën një kopje të fletës së fakteve me të drejtat e tyre vetëm në përfundim të procesit të marrjes në pyetje në komisariatit e policisë.</p> <p>Ndërsa në fq. 59, pika 5, të Raportit Vjetor 2022, gjendet rekomandimi adresuar Drejtorisë së Policisë së Shtetit dhe organeve të policisë në nivel vendor për krijimin e ambienteve (dhomave) më vete të intervistimit/ marrjes në pyetje të personave të privuar nga liria në mjediset e Policisë së Shtetit.</p>		
--	--	--	--	---	--	--

¹²<https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/reports/Raporti%20vjetor%20i%20veprimtarise%20se%20institucionit%20e%20Avokati%20e%20Popullit%20oper%20vitin%202022.pdf>

				<p>Raporti Vjetor 2023</p> <p>Në raportin vjetor për vitin 2023¹³, fq. 56, pika 1, është raportuar si problematikë e konstatuar nga MKPT-ja gjatë inspektimit të komisariateve të policisë, mungesa e ambienteve (dhomave) më vehte të intervistimit/marrjes në pyetje të personave të privuar nga liria në mjediset e Policisë së Shtetit.</p> <p>Në fq. 61, të Raportit Vjetor 2023, është referuar se MKPT ka evidentuar në komisaritet e policisë në Tiranë, mungesë të dhomave më vehte për intervistimin/marrjen në pyetje të personave të shoqëruar/ndaluar/arrestuar si dhe mungesë e instalimit të pajisjeve të sigurisë audio-vizive për të regjistruar procesin e marrjes në pyetje apo veprimeve të tjera procedurale hetimore me të</p>	
--	--	--	--	---	--

¹³ <https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/reports/FINAL-RAPORTI%20VJETOR%202023.pdf>

				<p>shoqëruarit/arrestuarit/ndaluarit.</p> <p>Raporti Vjetor 2024</p> <p>Në raportin vjetor për vitin 2024¹⁴, fq. 61 (paragrafi i fundit) dhe fq. 62 (paragrafi i pare) është raportuar si problematikë e konstatuar nga MKPT-ja gjatë inspektimit të komisariateve të policisë, mungesa e ambienteve (dhomave) më vehte të intervistimit/marrjes në pyetje të personave të privuar nga liria në mjediset e Policisë së Shtetit, të plotësuara me orenditë e nevojshme dhe të monitoruara me sistemin e kamerave audio-vizive, si një element parësor për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut. Kjo, pasi ka efekt parandalues për kryerjen e veprave të dhunshme dhe të dënueshme, si nga ana e të shoqëruarve, ndaluarve apo arrestuarve, ashtu dhe nga vetë punonjësit e policisë</p>	
--	--	--	--	--	--

¹⁴ <https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/reports/AVOKATI%20I%20POPULLIT%20-%20RAPORTI%20VJETOR%202024%20.pdf>

				<p>së shtetit.</p> <p>Po ashtu, Avokati i Popullit ka kërkuar mbajtjen në vëmendje të kësaj problematike që në projektet për përmirësimet e reja infrastrukturore në komisariate të ndryshme, të parashikohet në të tëra rastet dhoma e intervistimit si në dhomat e shoqërimit, ashtu edhe në ato të sigurisë.</p> <p>Gjithashtu, sipas gjetjeve të MKPT-së, fleta shpjeguese me të drejtat e personave të ndaluar u jepet atyre në fund të procesit të marrjes në pyetje. Në korridoret e dhomave të shoqërimit mungon lista e avokatëve mbrojtës me numrat e kontaktit të tyre (lista e dërguar nga dhoma e avokatisë për qarkun/bashkinë përkatëse). Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës ka sugjeruar në vijimësi dhënien e kartës të drejtave që në momentin e hyrjes në komisarimat. Rekomandimi i MKPT-së, në</p>		
--	--	--	--	---	--	--

			<p>përmbajtjen e tij nënkupton që karta me të drejtat, që gëzojnë personat kur hyjnë në mjediset e policisë, duhet t'u jepet edhe personave që mbahen në dhomat e shoqërimit, pra që në momentet e para të privimit të lirisë. Pasi këtyre personave ju kufizohet liria deri në 5 orë (maksimumi) qëndrimi në dhomat e shoqërimit, ata merren në pyetje nga specialistët e policisë dhe kanë të drejtën për njoftimin e familjarëve të tyre, të drejtën për qasje me avokat mbrojtës, etj. Në ambientin brenda dhomave të shoqërimit, si dhe në korridore nevojitej afishimi i kartave të reja të drejtave të përditësuara në përputhje me ligjin e ri për policinë e shtetit. Kjo, pasi është konstatuar se në posterat ekzistues, afati maksimal i shoqërimit ishte 10 orë, ndërkohë që me ligjin e ri është jo më shumë se 5 orë (fq. 72 e Raportit Vjetor 2024).</p> <p>Ndërsa, në fq. 55 - 56 të Raportit</p>		
--	--	--	--	--	--

			<p>Vjetor 2024, gjendet përshkrimi i një rasti, për të cilin kemi konstatuar se mosthirrja e psikologut për të qenë i pranishëm gjatë marrjes së deklarimeve shtetasit të mitur F.B. nga OPGJ, justifikohet me faktin se <i>“ai ishte pyetur si person që ka dijeni për rrethanat e hetimit dhe për këtë arsye nuk ka qenë e nevojshme pjesëmarrja e tij”</i>. Institucioni i Avokatit të Popullit ka vlerësuar se, veprimet e kryera nga OPGJ, A.S. në këtë rast, pa pjesëmarrjen e psikologut, vinin në kundërshtim të plotë dhe të hapur me nenin 18 të Kodit të Drejtësisë për të Mitur, ku parashikohet se: <i>“1. Në çdo fazë të procedimit penal me të mitur në konflikt me ligjin, si dhe gjatë pyetjes së të miturit viktimë ose dëshmitar, pavarësisht nga mosha mbi ose nën 14 vjeç, prania e psikologut është e detyrueshme...”</i>.</p> <p>Raporti Vjetor 2025</p> <p>Raporti Vjetor 2025 është ende në</p>		
--	--	--	---	--	--

				<p>fazën e hartimit të tij dhe nuk është botuar.</p> <p>Gjithashtu, ju bëjmë me dije se institucioni i Avokatit të Popullit ka botuar edhe disa raporte të veçanta ku mund të gjeni konstatime që kanë të bëjmë me intervistimin/pyetjen e personave të shoqëruar. Këto raporte i gjeni në faqen tonë zyrtare, në rubrikën botime/raporte të veçanta¹⁵.</p> <p>Më konkretisht:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Raporti i Avokatit të Popullit mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna për Shqipërinë nga Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimit Çnjerëzor dhe Degradues¹⁶; - Aktiviteti i Avokatit të Popullit të Shqipërisë në rolin e Mekanizmit Kombëtar për 		
--	--	--	--	--	--	--

¹⁵ <https://www.avokatipopullit.gov.al/sq/list/publications/rraporte-speciale-1/>

¹⁶ <https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/reports/RAPORTI%20I%20CPT%20AVOKATI%20I%20PPOPULLIT.pdf>

				<p>Parandalimin e Torturës, për vitin 2019¹⁷;</p> <ul style="list-style-type: none"> - Raport i Veçantë lidhur me respektimin e të drejtave kushtetuese dhe ligjore, si dhe e standardeve më të larta të të drejtave të njeriut e të palëve në procesin penal¹⁸. Ky është një raport përgjithësues nisur nga rasti i gazetarit Elton Qyno, i cili ndër të tjera, është ankuar se është mbajtur për disa orë (nga ora 11:00 deri në orën 18:00) në një nga zyrat e e SPAK¹⁹, duke e izoluar (mbyllur derën me çelës) dhe është pyetur lidhur me burimin e informacionit të publikuar, si dhe i është kërkuar dorëzimi i aparateve telefonikë që kishte në përdorim. 		
--	--	--	--	--	--	--

¹⁷<https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/reports/AKTIVITETI%20I%20AVOKATIT%20T%C3%8B%20POPULLIT%20T%C3%8B%20SHQIP%C3%8BRIS%C3%8B%20N%C3%8B%20ROLIN%20E%20MEKANIZMIT%20KOMB%C3%8BTAR%20P%C3%8BR%20PARANDALIMIN%20E%20TORTUR%C3%8BS.pdf>

¹⁸https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/website/reports/DRAFT%20per%20KONSULTIM%20PUBLIK%20..%20Raporti_drejtuar_SPAK_etj_per_Elton_Qyno.pdf

¹⁹ Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar

14	16 Prill 2026		27 Prill 2026	<p>Seksioni i Administratës pranw institucionit tonw ka trajtuar deri më tani një numër të kufizuar rastesh që lidhen me këtë fushë, konkretisht tre ankesa individuale të paraqitura nga subjekte/persona izikë.</p> <p>1. Në rastin e parë, ankuesi S. M. (ky rast është paraqitur nga një qytetar i përfaqësuar me avokat) ka paraqitur kërkesë për informacion pranë Avokatit të Popullit për të marrë informacion zyrtar lidhur me gjendjen e detyrimit financiar (kredisë) që rezulton në emër të shtetasit S. M.</p> <p>Më konkretisht, është kërkuar nga Avokati i Popullit informacion zyrtar për shlyerjen e detyrimit/kredisë në emër të këtij shtetasi dhe informacion për institucionin kompetent pranë të cilit duhet të paraqitet klienti i Avokates për shlyerjen e detyrimit (me institucionin Micro Credit Albania (MCA), si dhe sqarim lidhur me procedurën ligjore dhe administrative që duhet ndjekur për heqjen e kufizimit dhe largimin e emrit të shtetasit S. M. nga lista e personave të kufizuar për hapjen e llogarive bankare, pas shlyerjes së detyrimit.</p> <p>Në thelb, shqetësimi i ankuesit lidhet me mungesën e informimit të plotë dhe të qartë mbi gjendjen e detyrimit në të holla si rezultat i lidhjes së kontratës së huasë midis tij dhe subjektit Micro Credit Albania (MCA), duke pretenduar se nuk ka pasur transparencë të mjaftueshme mbi shumën e mbetur, interesat dhe penalitetet e aplikuar gjatë ekzekutimit të</p>	E Plote	Falas
----	---------------	--	---------------	---	----------------	--------------

				<p>kontratës, pasi nga ana e Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara (AAPSK) nuk i është dhënë asnjë informacion.</p> <p>Lidhur me këtë ankesë, institucioni i Avokatit të Popullit i është drejtuar Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara (AAPSK) me kërkesë për shpjegime lidhur me informacionin e munguar nga ana e këtij institucioni. ²⁰</p> <p>Çështja është ende në fazë hetimi nga ana e institucionit të Avokatit të Popullit.</p> <p>2. Në rastin e dytë, ankesa (ankesë e paraqitur nga shtetari E. S.) ka pasur si objekt një mosmarrëveshje ndërmjet palëve lidhur me ekzistencën dhe masën e detyrimit në të holla ndaj subjektit kredihënës, duke përfshirë kundërshtime mbi përlogaritjen e detyrimit dhe mënyrën e ndjekjes së tij.</p> <p>Më konkretisht, ankuesi ka pretenduar se ka kontaktuar si me subjektin kredihënës ashtu dhe Agjencinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara (AAPSK), por të dy subjektet e kanë informuar për vlerën e kredisë dhe shlyerjen e saj²¹, ndërkohë që ankuesi pretendon se vlera e penalteteve është tepër e lartë në raport me principalin, dhe se sipas tij maksimumi i penalteteve që shoqëria MCA mund të aplikojë është 30 % e vlerës së principalit. Më tej, ankuesi shprehet se është i</p>	
--	--	--	--	---	--

²¹ Ankuesi gjithashtu pretendon se është kontaktuar nga punonjës të AAPSK duke i dhënë këshilla lidhur me shlyerjen e kredisë.

				<p>gatshëm të shlyejë çdo detyrim të principalit dhe të interesave sipas kontratës, por jo të paguajë penalitetet, të cilat janë disa here më shumë se vlera e principalit.</p> <p>Lidhur me këtë rast institucioni i Avokatit të Popullit i është drejtuar Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara (AAPSK), Bankës së Shqipërisë, si dhe Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, me kërkesë për shpjegime dhe informacion.</p> <p>Më konkretisht, u janë drejtuar pyetje konkrete organeve si vijon:</p> <ul style="list-style-type: none">- Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara<ul style="list-style-type: none">• A është portofoli i kredive të Mikro Credit Albania Sh.p.k. nën administrimin tuaj?• A është transferuar e drejta e mbledhjes së detyrimeve tek AAPSK apo tek një subjekt tjetër?• Cili është subjekti ligjor që ka të drejtë të arkëtojë pagesat aktualisht?• A ekziston një llogari zyrtare bankare ku kredimarrësit duhet të vijnë pagesat?• A janë njoftuar zyrtarisht kredimarrësit për mënyrën e re të pagesës? Nëse po, si dhe kur?• A është ndërprerë apo pezulluar përkohësisht mbledhja e detyrimeve gjatë periudhës së sekuestrimit?• A janë deleguar të drejtat e administrimit tek një administrator shtetëror?• Vënie në dispozicion të të gjithë dokumentacionit të administruar në		
--	--	--	--	--	--	--

				<p>dosjen e kredisë së ankuesit</p> <p>Për penalitetet</p> <ul style="list-style-type: none">• Mbi çfarë baze ligjore janë llogaritur penalitetet gjatë periudhës kur subjekti ishte i sekuestruar?• A konsiderohet kjo periudhë si “forcë madhore” apo situatë që justifikon pezullimin e penaliteteve?• A është bërë rivlerësim i detyrimeve për kredimarrësit që nuk kanë pasur mundësi objektive për të paguar? <p>Për kontaktet informale</p> <ul style="list-style-type: none">• A janë të autorizuar punonjësit tuaj të kontaktojnë qytetarët në mënyrë informale (telefon)?• Si mund të verifikohet identiteti i personave që pretendojnë se janë përfaqësues të AAPSK? <p>-Bankës së Shqipërisë</p> <ul style="list-style-type: none">• Cili është statusi aktual ligjor dhe financiar i Mikro Credit Albania sh.a.?• A është pezulluar licenca apo aktiviteti i saj?• A ka udhëzime zyrtare për trajtimin e kredimarrësve në raste sekuestrimi të institucioneve financiare?• A ekzistojnë rregulla për pezullimin e interesave/penaliteteve në raste të tilla?• A është e ligjshme vijimi i penaliteteve kur kredimarrësi nuk ka pasur akses për të kryer pagesën?• Çfarë mekanizmash ankese ka		
--	--	--	--	---	--	--

				<p>kredimarrësi për mbrojtjen si konsumator financiar?</p> <p>-Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm</p> <ul style="list-style-type: none">• A parashikon vendimi nr. 4488 rregj, datë 18.07.2024 i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Tiranë, i masës së sigurimit pasuror/sekuestro preventive mbi personin juridik “Micro Credit Albania Sh.p.k, për mënyrën e administrimit të kontratave të huasë? Vënie në dispozicion të një kopjeje të vendimit gjyqësor nr. 4488 rregj, datë 18.07.2024 të Gjykatës së Shkallës së Parë, Tiranë.• A është përcaktuar pezullimi i detyrimeve apo vetëm administrimi i tyre?• A ka dispozita për mbrojtjen e palëve të treta (kredimarrësve)?• A janë deleguar të drejtat e administrimit tek një administrator shtetëror?• Kush është përfaqësuesi ligjor aktual? <p>Çështja është ende në fazë hetimi nga ana e institucionit të Avokatit të Popullit.</p> <p>3. Rasti i tretë i paraqitur nga K. V. lidhur me pretendimin për mosmarrjes parasyshe prej kredihënësit e parashkrimit të së drejtës për kërkimin e detyrimit në të holla ndaj tij, nga subjekti</p>		
--	--	--	--	---	--	--

				<p>kredihënës MCA.</p> <p>Ky rast është mbyllur nga ana e institucionit të Avokatit të Popullit duke orientuar ankuesin lidhur me rrugët ligjore që mund të ndjekë për parashkrimin e të drejtës për kërkimin e detyrimit nga subjekti MCA.</p> <p>Më tej, në referim të pyetjeve të paraqitura në shkresën e TV MCN se:</p> <p><i>A ka verifikuar Avokati i Popullit nëse qytetarët janë detyruar të paguajnë detyrime disproporcionale për shkak të transferimit të kredive, në përputhje me ligjin nr. 9902/2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”.</i></p> <p>Përgjigje: Sikurse paraqitur më sipër, pranë seksionit të administratës është duke u trajtuar vetëm një rast (rasti i ankuesit E. S.). në të cilin ankuesi ka ngritur problematikë për ekzistencën e detyrimeve disproporcionale. Në këtë rast nuk ka pasur pretendime konkrete që ky disproporcionalitet ka ardhur nga transferimi i kredive.</p> <p><i>A ka marrë Avokati i Popullit ankesa konkrete nga qytetarët për rritje të padrejtë të borxheve dhe interesave, dhe sa raste janë regjistruar?</i></p> <p>Përgjigje: Nga seksioni i administratës, sikurse pasqyruar më sipër është marrë për shqyrtim vetëm një ankesë (ankesa e shtetasit E. S.).</p> <p><i>A ka ndërhyrë Avokati i Popullit për të ndaluar praktikat e abuzimit financiar nga bankat dhe mikrokreditë dhe cilat kanë qenë</i></p>		
--	--	--	--	--	--	--

				<p><i>rezultatet konkrete?</i></p> <p>Përgjigje: Sikurse paraqitur më sipër, në rastin E.S. çështja është në fazë hetimi.</p> <p><i>A ka bashkëpunuar Avokati i Popullit me Bankën e Shqipërisë, Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare ose Ministrinë e Financave për të evidentuar dhe ndaluar këto praktika?</i></p> <p>Përgjigje: Sikurse paraqitur më sipër, në rastin E.S. çështja është në fazë hetimi, ku kemi adresuar dhe pyetjet specifike ndaj Bankës së Shqipërisë.</p> <p><i>A ka shqyrtuar Avokati i Popullit nëse qytetarët janë informuar në mënyrë të qartë mbi interesat, penaltitetet dhe transferimin e kredive në përputhje me ligjin nr. 9902/2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”?</i></p> <p>Përgjigje: Sikurse paraqitur më sipër, në rastin E.S. dhe S.M. çështja është në fazë hetimi lidhur me adresimin e kësaj problematike.</p> <p><i>A ka dhënë Avokati i Popullit rekomandime konkrete për të ndryshime ligjore ose rregullatore për mbrojtjen e qytetarëve debitor?</i></p> <p>Përgjigje: Sikurse shprehur më sipër, institucioni AP është ende në fazë hetimi.</p> <p><i>Në rast të moszbatimit të ligjit nga institucionet financiare, a ka ndërmarrë AP masa apo ka raportuar publikisht këto shkelje, në bazë të kompetencave që jep ligji për</i></p>	
--	--	--	--	---	--

				<p><i>avokatin e popullit?</i></p> <p>Përgjigje: Sikurse shprehur më sipër, institucioni AP është ende në fazë hetimi.</p> <p><i>A ka analizuar Avokati i Popullit ndikimin financiar tek qytetarët nga interesat dhe penalitetet e llogaritura pas afateve të parashikuara sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë?</i></p> <p>Përgjigje: Me rastin e administrimit të informacionit, kontratës së huasë, sipas rastit, do të analizohet edhe çështja e vendosjes së interesave dhe penaliteteve në kontratë.</p> <p><i>A ka evidentuar Avokati i Popullit praktika bashkëpunimi ndërmjet bankave dhe mikroredisë që çojnë në rritje të detyrimeve ndaj qytetarëve?</i></p> <p>Përgjigje: Nuk është konstatuar një situatë e tillë.</p> <p><i>A garanton Avokati i Popullit që qytetarët nuk po i nënshtrohen detyrimeve të shumëfishta në kundërshtim me legjislacionin në fuqi?</i></p> <p>Përgjigje: Institucioni, në ushtrim të mandatit të tij kushtetues dhe ligjor, nuk ka kompetencë për të garantuar në mënyrë absolute mungesën e shkeljeve të mundshme në marrëdhëniet kontraktore ndërmjet subjekteve private, përfshirë edhe rastet e pretenduara për detyrime të shumëfishta.</p> <p>Roli i institucionit konsiston në shqyrtimin e ankesave individuale dhe në vlerësimin e respektimit të standardeve të të drejtave të njeriut nga ana e organeve publike, si dhe në</p>	
--	--	--	--	--	--

				<p>adresimin e problematikave me karakter sistemik, në rast se ato evidentohen.</p> <p>Gjatë hetimi të çështjes do të mundësohet evidentimi i situatës për të cilën (nëse do të jetë rasti) mund të ndërhyhet për garantimin e së drejtës.</p> <p><i>A ka kryer Avokati i Popullit hetime ose monitorim mbi vendosjen e interesave dhe penaliteteve nga institucionet financiare?</i></p> <p>Përgjigje: Sikurse shprehur më sipër, institucioni AP është ende në fazë hetimi.</p> <p><i>A ka raportuar Avokati i Popullit në Kuvend për praktikat abuzive të bankave dhe mikrokredisë, në përputhje me detyrimet ligjore të raportimit?</i></p> <p>Përgjigje: Deri në këtë moment, institucioni nuk ka raportuar në Kuvend problematika të tilla me karakter specifik për praktikat abuzive në fushën e bankave apo mikrokredisë. Çështja është ende në fazë hetimi dhe AP nuk mund të shprehet lidhur me sa kërkuar.</p> <p><i>A ka një plan konkret Avokati i Popullit për të parandaluar në të ardhmen shfrytëzimin financiar të qytetarëve</i></p> <p>Përgjigje: Sa kohë që çështja është në fazë hetimi, institucioni nuk mund të shprehet dhe nuk mund të paragjykojë mënyrën e përfundimit të kësaj çështje dhe hetimi administrativ. Sikurse parashikon ligji për avokatin e popullit, hetimi nga AP kryhet duke marrë informacione nga organet e administratës shtetërore, informacion të cilin nuk e kemi ende në dispozicion.</p>		
--	--	--	--	---	--	--

			<p><i>A ka verifikuar AP nëse gjatë transferimit të kredive janë respektuar të dhënat personale të qytetarëve dhe afati i parashkrimit 10-vjeçar, në përputhje me nenet 114-115 të Kodit Civil dhe legjislacionin përkatës?</i></p> <p>Përgjigje: Lidhur me të dhënat personale nuk janë objekt i kompetencës së institucionit të Avokatit të Popullit, por të Komisionerit për të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale.</p> <p>Sa i përket pyetjes për parashkrimin e të drejtës së kërkimit të detyrimit në të holla nga shoqërisë e mikrokredisë, kjo është çështje që mund të zgjidhet vetëm në rrugë gjyqësore.</p> <p><i>A ka ndërhyrë konkretisht Avokati i Popullit për të ndaluar praktikat që çojnë në rritje dispropocionale të borxhit dhe nëse jo, pse nuk është ushtruar kompetencave ligjore për mbrojtjen e qytetarëve sipas ligjit nr. 8454/1999?</i></p> <p>Përgjigje: Sikurse më sipër, çështja është ende në fazë hetimi.</p> <p>Avokati i Popullit rithekson angazhimin e tij për të garantuar respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të individit, në përputhje me mandatin kushtetues dhe ligjor. Institucioni mbetet i hapur për shqyrtimin e çdo ankese apo indicie të re që mund të paraqitet në këtë fushë dhe do të ndërmarrë veprimet përkatëse në rast se evidentohen shkelje apo problematika me karakter sistematik, duke bashkëpunuar, kur është e nevojshme, me autoritetet përgjegjëse dhe duke informuar publikun dhe Kuvendin e Shqipërisë në përputhje me detyrimet ligjore të raportimit.</p>	
--	--	--	---	--

--	--	--	--	--	--	--